



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural hap thirrje për përfaqësues të shoqërisë civile si monitorues i procesit të vlerësimit të granteve për zhvillim rural 2022.

Për të përzgjedhur përfaqësuesit e shoqërisë civile në monitorimin e procesit të vlerësimit të granteve, ftohen OSHC-të aktive në lëmin e bujqësisë anti-korrupsioni, ekonomisë dhe medias në Kosovë për të nominuar përfaqësuesit e tyre. Ftesa është e hapur për të gjitha OSHC-të nga lëmi e bujqësisë të regjistruara dhe rrjetet e OSHC-ve në Kosovë, pavarësisht anëtarësimit në Platformën CiviKos.

KRITERET PËR ORGANIZATAT QË NOMINOJNË KANDIDATËT

Të drejtën për të nominuar kandidatë kanë të gjitha OShC-të që:

- Janë të regjistruara sipas Ligjit për Liri të Asocimit në Kosovë;
- Ekzistojnë të paktën gjatë 3 viteve të fundit dhe punojnë në fushën e bujqësisë, anti-korrupsioni, ekonomisë dhe medias;

Për t'u nominuar nga një OShC, 10 (dhjetë) kandidatët duhet të plotësojnë kriteret në vijim:

- Të jetë i/e angazhuar në sektorin e shoqërisë civile në Kosovë;
- Të jetë shtetas/e i/e Republikës së Kosovës;
- Të ketë kualifikim / por jo e domosdoshme në fushën e bujqësisë, ekonomisë, drejtësisë, medias, komunikimit e të ngjashme (BA/MSC);
- Të ketë përvojë pune në shoqëri civile, në fushat e lartecekura minimumi 6 muaj;
- Mos të ketë qenë i angazhuar në 5 vitet e fundit në AZHB, MBPZHR dhe institucionet tjera relevante.

PROCEDURA E NOMINIMIT DHE VERIFIKIMIT

E gjithë procedura e nominimit dhe përzgjedhjes menaxhohet nga Sekretariati i Platformës CiviKos, nëpërmjet procesit të nominimit dhe Formularëve për Votim, ku përcaktohen qartë të gjitha kushtet e kërkuara dhe dokumentet shtesë.

Të gjitha OShC-të që nominojnë kandidatët e tyre obligohen që në periudhën nga 18.08.2022-23.08.2022 të dërgojnë dokumentet e kërkuara për nominim të kandidatit/es si më poshtë:

- 1. Certifikatën e regjistrimit të OJQ-së;**
- 2. Një përshkrim (max 1 faqe) për fushëveprimtarinë e organizatës dhe misionin;**
- 3. Një cv të kandidatit/es që organizata e nominon.**

Të gjitha këto dokumente mund ti dërgoni përmes email në info@civikos.net, apo përmes postës në adresën Rr. Bedri Pejani 7/A 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Një panel verifikues i përbërë nga përfaqësues të Sekretariatit të Platformës CiviKos, dhe një përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural konfirmojnë plotësimin e kriterëve të nominuarëve, para zyrtarizmit të listës përfundimtare për votim.

PROCEDURA E VOTIMIT

Të drejtë për të votuar për kandidatët e nominuar kanë të gjitha OShC-të e regjistruara sipas Ligjit për Liri të Asociimit në OJQ në Republikën e Kosovës. Votuesit mund të hedhin votën e tyre me e-mail, në email adresën info@civikos.net, postë të rregullt, ose personalisht në zyrën e CiviKos në adresën Rr. Bedri Pejani 7/A 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Në rastin e votimit me e-mail ose me postë të rregullt, organizata që voton duhet të dërgojë fletëvotimin e plotësuar dhe kopjen e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së. Në rastin e votimit në zyrën e CiviKos, organizatat duhet të dorëzojnë kopjen e certifikatës së regjistrimit të OJQ-së dhe të hedhin fletëvotimin e tyre në kutinë e votimit në zyrën e CiviKos. Votimi anonim mund të bëhet vetëm nëpërmjet votimit në zyrën e CiviKos.

Procesi i votimit do të organizohet dhe menaxhohet nga një komision i përbërë nga personeli i Sekretariatit të Platformës CiviKos, që caktohet nga Drejtori Ekzekutiv i CiviKos. Pas përfundimit të afatit për votim, komisioni i Sekretariatit të Platformës CiviKos do të numërojë fletëvotimet për të përcaktuar se cili(a) kandidat(e) ka marrë numrin më të madh të votave. Nëse dy kandidatë marrin numrin e barabartë të votave, përfaqësuesi i OShC-ve do të përcaktohet me short në mes tyre.

Për të mbikëqyrur procesin e numërimit të votave, Platforma CiviKos do të ftojë në cilësinë e vëzhguesve të gjitha OShC-të që kanë bërë nominime, rrjetet aktive të shoqërisë civile, përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

